



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:206310

Datë: 02.09.2024

Numri i dokumentit: 06108624

PKR.nr.140/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – Departamenti i Krimeve të Rënda, Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari Gazmend Bahtiri, me anëtarët e trupit gjykues - gjyqtarët Gëzim Ademi dhe Gent Beka, bashkëpunëtoren profesionale Albana Curri dhe procesmbajtësen Dalina Kërçeli – Abdullahu - zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.S., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, e evidentuar me shenjën PP.I.nr.802/2022, të datës 10.03.2023, e ri-kualifikuar sipas detyrës zyrtare nga gjykata në veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 i KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor – publik me datë 07.08.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit A.H., të akuzuarit A.S. dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare P.H. avokat në Prishtinë, po të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 02.09.2024, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.S., i biri i B. dhe Sh. (e gjinisë Z.), i lindur me ... në P., tani me vendqëndrim në fshatin M. e E., Komuna F. K., rruga “...” pa numër, me numër personal të identifikimit ... të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme - Dizajner i rrobaqepsisë, punëtor në ndërmarrjen “F. H.”, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar,

shtetas i Republikës së Kosovës, ka qëndruar në masën e paraburgimit prej datës 06.10.2022 deri me datën 28.12.2022.

## Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Pa autorizim ka poseduar substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, në atë mënyrë që me datën 06.10.2022, rreth orës 22:00/h, në rrugën “N. T.” afër Rrethit në Fushë Kosove, gjatë patrullimit nga policia, me të vërejtur veturën e tipit “O.I.” me ngjyrë hiri, me targa ....., të cilën e ngiste i pandehuri, ndërsa pasgjer ishte dëshmitari G.R., dhe me të cilën ka shkaktuar kundërvajtje në komunikacion, kanë ndaluar të pandehurin dhe me rastin e legjitimitetit të të pandehurit A.S., kanë ndjerë aromën e substancës narkotike Marihuanë, ku të njëjtin e kanë urdhëruar që të del nga vetura për t’u kontrolluar, mirëpo i pandehuri me shpejtësi të madhe me veturë ka ikur nga aty duke shkuar rrugëve lokale dhe gjate ikjes, nga dritarja e veturës në rrugën “A. Zh.” ka hedhur një qese me substancë narkotike të dyshuar si marihuanë, e pastaj i pandehuri është ndalur afër shkollës “H.S.” ku është arrestuar, ndërsa policia te i pandehuri ka gjetur dhe sekuestruar një qese najloni me marihuanë, në peshë prej 89.89 gram, një letër mbështjellëse me marihuanë, në peshë prej 0.19 gram, dhe dhjetë (10) qese të vogla me marihuanë, me peshë prej 11.35 gram, të cilat pas ekspertizës ka rezultuar se është prezent Kanabisi (marihuana) që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), ndërsa pesha neto e përafërt është 93.74 gram.

Me këtë ka kryer veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 i KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 79 lidhur me nenin 269 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe nenet 276, 358, 360, 364, 365, 367, 368, 369 dhe 452, të KPPRK-së, të akuzuarin e:

## G J Y K O N

Me burgim në kohëzgjatje prej dy (2) viteve dhe dënim me gjobë në shumë prej 1,000.00 (një mijë) euro, të cilat dënime do të ekzekutohen në afatin prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Në dënimin e shqiptuar me burgim, të akuzuarit i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 06.10.2022, deri me datë 28.12.2022.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund t'a paguaj gjobën e lartcekur, gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësojë në dënim me burgim, duke e llogaritur 20,00 (njëzet) euro, e barabartë me një (1) ditë burgim.

URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i substancës narkotike marihuanë, pesha neto e përgjithshme e përafërt: 93.74±0.0001

DETYROHET Policia e Kosovës - Njësi DHTN - DKKO në Prishtinë, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të e bëjë asgjësimin e substancës narkotike të lartpërmendur.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale - paushallit gjyqësor, të e paguajë shumën prej 100,00 (njëqind) euro dhe në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit, shumën prej 50,00 (pesëdhjetë) euro, e gjitha këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

## A r s y e t i m

### *Aktakuza*

Prokuroria Themelore Prishtinë - Departamenti i Krimeve të Rënda, në këtë gjykatë ka parashtruar aktakuzën e evidentuar me shenjën PP.I.nr.802/2022, të datës 10.03.2023, kundër të akuzuarit A.S. për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së.

### *Kompetenca e gjykatës*

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështrimin e aktakuzës ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore. Sa i përket kompetencës territoriale gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 të KPPRK-së, kompetencë territoriale për t'u gjykuar një çështje juridiko-penale, ka gjykata në territorin e së cilës është kryer apo është tentuar të kryhet vepra penale, apo në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja. Në rastin konkret vepra penale për të cilën është akuzuar A.S. ka të bëjë me territorin e Prishtinës, andaj Gjykata Themelore në Prishtinë, ka kompetencën territoriale në gjykimin e kësaj çështje.

Duke vlerësuar kompetencën lëndore, gjykata konstaton se vepra penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së, e cila nga organi i akuzës fillimisht i është vënë në barrë të akuzuarit të lartcekur, është e përcaktuar si krim i rëndë me nenin 22 të KPPRK-së, andaj gjykata konstaton se Departamenti për Krime të Rënda, ka kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje.

#### *Shqyrtimi fillestar*

Gjykata pasi që fillimisht kishte vlerësuar kompetencën, si dhe ka vlerësuar të metat formale dhe juridike të aktakuzës, duke vepruar sipas kësaj çështjeje penale, ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 03.05.2024, në të cilin shqyrtim kanë prezantuar të gjitha palët në procedurë, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë lidhur me veprën penale të cilën e ngarkon aktakuza, për çka gjykata i ka informuar të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij për të drejtat e tyre nga neni 240 paragrafi 7 të KPPRK-së.

#### *Konfirmimi i aktakuzës*

Mbrojtësi i të akuzuarit A.S. – P.H. , avokat në P., brenda afatit ligjor (datë 17.05.2024) në këtë gjykatë ka parashtruar kërkesë për hudhjen e aktakuzës, e cila është kundërshtuar nga ana e organit të akuzës, përmes përgjigjes së parashtruar me datë 30.05.2024.

Gjykata me aktvendimin PKR.nr.140/2023, të datës 06.06.2024, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për hudhjen e aktakuzës të parashtruar nga mbrojtësi i të akuzuarit A.S. – P.H. , avokat

në P., i cili vendim është vërtetuar me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, i evidentuar me shenjë PN.ND.nr.1007/24, të datës 28.06.2024.

### *Shqyrtimi gjyqësor*

Gjykata me datë 07.08.2024 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor në këtë çështje penale, ku të akuzuarit përsëri i është dhënë mundësia për t'u deklaruar lidhur me pranimin ose jo të fajësisë për veprën penale, e që i njëjti nuk e ka pranuar fajësinë në raport me veprën penale për të cilën akuzohet, ashtu që shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën hyrëse.

### *Fjala hyrëse e palëve*

Prokurori i Shtetit në fjalën hyrëse ka deklaruar si vijon: pas administrimit të të gjitha provave konsiderojmë se do të vërtetohet përtej dyshimit mirë të bazuar se me veprimet e të akuzuarit formësohen elementet e veprës penale për të cilën akuzohet. Në raport me personin e përmendur si dëshmitar në dispozitiv të aktakuzës G. R. e që në shkresat e lëndës rezulton se i njëjti është marrë në pyetje edhe në prokurori me datën 07.12.2022, por duke marrë parasysh faktin se i njëjti paraprakisht ka qenë i bashkëpandehur në aktvendimin për fillimin e hetimeve, e duke u bazuar në dispozitat aktuale të KPPRK-së, neni 123 paragrafi 1 pika 1.3 si Kod i zbatueshëm aktualisht, konsiderojmë se i bashkëpandehuri nuk mund të procedohet si dëshmitar në të njëjtën çështje ku është ka qenë i pandehur andaj për shkak të kësaj pengese ligjore të paraqitur pas ngritjes së aktakuzës në pamundësi të propozimit të tij si dëshmitar heqim dorë nga dëgjimi i tij në këtë procedurë, e që në rastin konkret nuk ka qenë i propozuar as në aktakuzën e ngritur nga prokurori i çështjes.

Mbrojtësi i të akuzuarit në fjalën hyrëse ka deklaruar si vijon: fillimisht qëndrojmë mbrapa pretendimeve të paraqitura në kërkesën për hedhje të aktakuzës, ndërsa nga gjykata në këtë shqyrtim gjyqësor kërkojmë që theksin të e vë në hipotezën e dispozicionit të kësaj norme juridike konkretisht të qëllimi si element subjektiv dhe volitiv i kësaj veprë penale e që është kryesor të faktohet në këtë shqyrtim gjyqësor për arsye se nga provat e paraqitura siç janë vërtetimi mbi sekuestrimin e sendit i datës 06.10.2022 dhe raporti i ekspertimit i datës 20.01.2023, vërtetojnë veprën penale vetëm në kuptim të elementeve objektive të saj.

*Procedimi i provave materiale të administruara në shqyrtim gjyqësor*

Gjatë shqyrtimit gjyqësor është bërë administrimi i provave materiale të propozuara nga prokurori i shtetit: Raporti fillestar i incidentit i datës 06.10.2022, Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 06.10.2022, Lista e dëshmive dhe zinxhiri i ruajtjes i datës 07.10.2022, Raporti i oficerit i datës 06.10.2022, Raport i ekspertimit i datës 20.01.2023, si dhe Foto albumi.

*Deklarimi i të akuzuarit*

Gjykata ka vazhduar me deklarimin e të akuzuarit A.S. i cili ka theksuar se ditën kritike kishte qenë në punë, kur e kishte kryer orarin e punës rreth orës 17:00/h, kishte shkuar në shtëpi dhe pas pak e kishte marrë veturën të tipit “O. I.” dhe kishte shkuar te shtëpia e G., e kishte marrë atë me veturë me qëllim për të pirë kafe në P., duke u nisur nga F. K.. Kur kishin mbërritur në lokalet e “L.”, kishin parkuar veturën afër rrugës dhe i kishte thënë G., më prit se kam për t’u takuar me dikë, duke shkuar te lokalet e “L.”, kishte takuar personin me nofkën B., të cilin e kishte njohur edhe më parë, ku fillimisht i kishte kërkuar dhjetë qese substancë narkotike ngase kishte paratë e pagës duke dashur që të sigurojë më shumë sasi për konsumim, ngase kishte qenë konsumues edhe para asaj kohe, i kishte marrë ato dhjetë qese, i cili i kishte thënë se ka edhe disa sasi dhe kishte mundësi që të ia lerë më lirë. Dy apo tre qese në atë kohë i kanë shkuar në ditë. Pastaj kishte vendosur që t’a blejë edhe sasinë tjetër duke ia dhënë shumën prej 250,00 (dyqind e pesëdhjetë) euro. E cila sasi do t’i shërbente edhe për dy muaj. Kishte hipur në veturë, G. nuk kishte pasur njohuri për asgjë, substancën narkotike e kishte lënë në karrige të shoferit, e që G. nuk e kishte vërejtur. Më pas kanë shkuar te rrethi në F. K.dhe te market “Ll.”, e ka ndaluar veturën për t’i marrë disa pije dhe disa rizilla të cilat shërbejnë për të mbështjellë cigaren. Aty, në veturë sa kishte qenë vetëm e kishte ndreq një cigare dhe e kishte ndezë një me marihuanë (të cilën nuk kishte arritur që t’a përfundoj deri në fund) dhe duke u nisur në drejtim të fshatit të tij, e kishte bërë një kundërvajtje në rreth dhe pas 100 metër e kishte parë policinë me rotacion të cilët i kanë thënë me u ndalë. Në momentin e ndaljes ia kishin kërkuar librezën, e kishin dëgjuar aromën e cigares – marihuanes, duke e urdhëruar të njëjtin që të dal nga makina për bastisje. Në atë moment e kishte ngritë xhamin dhe e kishte nisur veturën me shpejtësi për t’u larguar diku rreth 200 metër, duke e hapur xhamin për t’a hedhur substancën narkotike (ashtu siç e kishte blerë) nga xhami diku në qoshe të rrugës. Kishte vazhduar edhe pak me makinë dhe ishte ndaluar ku edhe është arrestuar nga policia të cilët e kishin gjetur edhe

substancën narkotike. G. nuk kishte konsumuar narkotik, por kishte qenë në dijeni që i njëjti ishte përdorues i narkotikut. I njëjti që pesë (5) vite është përdorues dhe gjatë këtyre viteve në baza ditore e ka përdorur substancën narkotike. Nuk kishte marrë ndonjë tretman mjekësor apo të tillë ngase kishte qëndruar në paraburgim diku tre (3) muaj për këtë çështje, e cila i kishte ndihmuar për t'a ndërprerë konsumimin dhe pasi kishte dalë nga paraburgimi kishte filluar që të punoj dhe tani nuk është konsumues.

### *Fjala përfundimtare e palëve*

Prokurori i shtetit A.H. në fjalën përfundimtare ndër të tjera ka deklaruar si vijon: në shqyrtimin gjyqësor pas administrimit të provave të propozuara por edhe nga mbrojtja e të pandehurit, konsiderojmë se është vërtetuar dhe nuk është kontestues fakti se i pandehuri ditën kritike ka blerë dhe poseduar substancë narkotike të cilën gjatë ikjes nga policia për shkak të kundërvajtjes edhe e kishte hedhur, e cila sasi është gjetur dhe sekuestruar nga i akuzuari. Ajo që ishte kontestuese gjatë shqyrtimit gjyqësor ishte fakti i qëllimit të blerjes dhe posedimit të substancës narkotike e që qëllimi është edhe element qenësor i kësaj vepre dhe se nga administrimi dhe vlerësimi i provave por edhe kundërthëniet në mbrojtjen e të akuzuarit, rrethana këto mbi bazën e të cilave nxirret qëllimi i veprës. Konsiderojmë se tani më është vërtetuar se blerja e kësaj substance dhe mbajtja e saj për aq kohë në posedim ka pasur qëllim të shitjes dhe shpërndarjes së pa autorizuar, e kjo posaçërisht duke u bazuar në sasinë, mënyrën e ndarjes së kësaj sasive, veçanërisht në faktin e dhjetë qeseve në peshë të përafërt, të njëjtë e gatshme për shitje. Andaj, duke marr parasysh edhe mbrojtjen e tij, i njëjti e ka pranuar se edhe më herët ka qenë i gjykuar për posedim të narkotikëve por jo në sasi të tilla, duke konsideruar se edhe kjo është rrethanë me të cilën nxirret dhe vërtetohet qëllimi që kishte i akuzuari në raport me substancën që është objekt i aktakuzës. Gjykatës i ka propozuar që të akuzuarin t'a gjejë penalisht përgjegjës dhe t'a shpallë fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe ndaj tij të shqiptojë dënim në bazë të ligjit e po ashtu të shqiptohet edhe dënimi plotësues i konfiskimit dhe shkatërrimit të substancës narkotike si dhe i njëjti të obligohet në përmbushjen e shpenzimeve të kësaj procedure penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.S. - P.H. avokat në P., në fjalën përfundimtare ndër të tjera ka deklaruar si vijon: sipas pretendimeve të mbrojtjes gjatë shqyrtimit gjyqësor me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar dyshimi i bazuar mirë, e i cili i atribuohet qëllimit të shitjes apo shpërndarjes së substancës narkotike. Mbrojtja obligohet të i kundërshtoj disa nga pretendimet

e prokurorit të potencuara paraprakisht pasi që nuk pati asnjë kundërthënie nga i mbrojturi i tij, respektivisht nuk është artikulluar asnjë kundërthënie e tillë, mirëpo vetëm është potencuar. Tutje e ka kundërshtuar pretendimin rreth të kaluarës së të mbrojturit të tij e cila asocon se i njëjti herë pas here kishte blerë substanca me peshë përafërsisht të njëjtë, pasi që prokurori gjatë shqyrtimit gjyqësor kishte qenë i obliguar që të vërtetojë dyshimin për veprën konkrete – rastin konkret. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të ketë parasysh dispozitat ligjore nga neni 359 i KPPRK-së dhe të e ndryshoj kualifikimin ligjor të veprës penale nga vepra penale e neni 267 të KPRK-së, në veprën penale nga neni 269 të KPRK-së, e cila i atribuohet posedimit të paautorizuar të narkotikëve, vepër penale kjo për të cilën i mbrojturi i tij edhe në seancën e shqyrtimit fillestar kishte shprehur gatishmëri që t'a pranojë fajësinë.

I akuzuari A.S. në fjalën përfundimtare ka deklaruar si vijon: e mbështetë në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, jam penduar, ndjejë keqardhje, me premtimin se nuk do të përsërisë më vepër penale.

#### *Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor*

Gjykata për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka administruar provat materiale të propozuara nga prokurori i shtetit në mënyrën siç më poshtë vijon:

- Raporti fillestar i incidentit i datës 06.10.2022;
- Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 06.10.2022;
- Lista e dëshmimeve dhe zinxhiri i ruajtjes i datës 07.10.2022;
- Raporti i oficerit i datës 06.10.2022;
- Raport i ekspertimit i datës 20.01.2023, si dhe
- Foto albumi.

#### *Rrethanat jokontestuese dhe kontestuese*

Fillimisht gjykata konstaton se në këtë çështje penale nuk ka qenë kontestues fakti se i akuzuari A.S. ditën kritike me datë 06.10.2022, derisa kishte qenë në veturën “O.I. ”, së bashku me personin G. R. (duke iu ikur patrullës policore), kishte poseduar substancë narkotike në veturë, e cila substancë ishte hedhur nga xhamat e veturës dhe se i njëjti kishte qenë përdorues i këtyre



substancave. Në rastin konkret kontestues në këtë çështje penale kishte qenë fakti se i akuzuari A. substancën narkotike në fjalë, e kishte poseduar apo përdorim – konsumin personal apo për shitje tek personat tjerë?!

## VLERËSIMI I PROVAVE

Gjykata në vazhdim do të analizoj secilën provë si vijon:

Nga Raporti fillestar i incidentit i datës 06.10.2022, i përpiluar nga Policia e Kosovës - Drejtoria Rajonale e Policisë, është vërtetuar se me datë 06.10.2022, zyrtarët policor janë informuar se patrulla policore kishte qenë duke e ndjekur një veturë dhe nga vetura e të dyshuarit kanë hedhur qese ku dyshohej se përmbanin substanca narkotike si dhe thike – brisk. Vendi i ngjarjes ishte në rrugën “H. H.” dhe “A. Zh.” në F.K., ku personat e dyshuar i kanë ikur ndaljes së veturës. Gjendja faktike e gjetur ishte fiksuar me anën e fotografimit në bazë të teknikave të cilat i kanë zhvilluar zyrtarët kompetent policor.

Nga Vërtetimi mbi sekuestrimin e sendeve i datës 06.10.2022, me numër të rastit 2022-AE-1438, është vërtetuar se DRP – Prishtinë, Stacioni Policor në F.K., nga i akuzuari, kanë sekuestruar: Një qese të mbushur me substancë të dyshimtë marihuanë me peshë 89.89 gram; Një (1) letër mbështjellëse me sasi të dyshimtë marihuanë 0.19 gram dhe dhjetë (10) qese të vogla me sasi të dyshimtë marihuanë, pesha totale: 11:35 gram.

Nga Lista e dëshmimeve dhe zinxhiri i ruajtjes i datës 07.10.2022, është vërtetuar rrethana se me datë 06.10.2022 lista e dëshmimeve që janë gjetur në vendin e ngjarjes, ditën kritike, renditen si në vijim: 1. D#1 Një qese e najlonit me substancë të dyshimtë marihuanë me peshë 89.89 gram, vendi i gjetjes: Në trotuar, rruga “H. H.” F. K.; 2. D#2 Një letër mbështjellëse me sasi të dyshimtë marihuanë: 0.19 gram, vendi i gjetjes: Në rrugë “A. Zh.” F. K.; 3. D#3 Dhjetë qese të vogla me sasi të dyshimtë marihuanë, pesha totale: 11. 35 gram, vendi i gjetjes: Në trotuar “A. Zh.” F. K.

Nga Raporti i oficerit i datës 06.10.2022, është vërtetuar se me datën 06.10.2022, rreth orës 21:43/h, Njësia policore e SP F.K., gjatë patrollimit në Rrugën e P., ia ka bërë me shenjë që të ndalet veturës së tipit “O. I.” me targa ..., brenda së cilës gjendeshin dy të dyshuarit e cekur më lartë, të cilët nuk e kanë zbatuar urdhrin e ligjshëm të zyrtarëve policor duke ikur në drejtim të

rrugës “A.Zh.” me ç’rast pas kërkimit të asistencës dhe nga njësitë tjera, është arritur të ndalet vetura dhe dy personat janë arrestuar dhe janë sjellë në stacion. Në vendin e ngjarjes ku është arritur të ndalet vetura, jashtë veturës në tokë janë gjetur një qese e substancës së dyshuar narkotike të llojit marihuanë. Gjatë intervistimit i dyshuari A.S ka pranuar se kishte hedhur tre qese narkotike nga dritarja e automjetit gjatë ikjes. Momenti i ikjes së veturës së dyshuar nga Policia dhe hudhjes së sendeve të cekura më lartë është regjistruar edhe nga kamerat e sigurisë. Lidhur me rastin janë njoftuar organet kompetente ndërsa të dyshuarit kanë qenë në masën e ndalimit për 48 orë.

Nga Raport i ekspertimit i përpiluar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, me datë 20.01.2023, është provuar rrethana së në bazë të karakteristikave morfologjike dhe përbërjes kimike dëshmitë #1, #2.1, #2.2, #2.3, #2.4, dhe #3, përmbajnë marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol (THC), pesha neto e përgjithshme e përafërt:  $93.74 \pm 0.0001$ .

Nga Foto albumi i përpiluar nga Policia e Kosovës, me numër të dosjes së hetimeve 2022-AE-1438 dhe numër të dosjes së forenzikës 91/2022, shihen pamjet në rrugën “H.H.” në F. K. afër hyrjes së furrës së bukës “D.” përkatësisht qese të mbushura me substancë të dyshimtë narkotike – marihuanë. Po ashtu shihet vetura e markës “O.” ngjyrë hiri, me targa ...., në të cilën veture kishin qenë G. R. - shofer, si dhe këtu i akuzuari A.S. – pasagjer. Si dhe pamje të dhjetë qeseve të mbushura me substancë narkotike të cilat ishin hedhur nga dritarja e veturës së lartcekur. Po ashtu në foto dokumentacion shihet edhe një peshore, me të cilën është peshuar substanca narkotike e cila është edhe objekt i kësaj çështje penale.

#### *Ri-kualifikimi i veprës penale*

Trupi gjykues pas vlerësimit të detajuar të pretendimeve nga organi i akuzës në raport me përshkrimin faktik të ngjarjes, provave që janë deponuar lidhur me rastin konkret, si dhe provave që janë administruar në shqyrtim gjyqësor, e duke u bazuar në nenin 359 të KPPRK-së, me të cilën rregullohet *identiteti subjektiv dhe objektiv i aktgjykimit me aktakuzën*, gjegjësisht paragrafi 2 i nenit në fjalë, ku në mënyrë decisive është përcaktuar se: “Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës”, e ka ndryshuar përshkrimin e gjendjes faktike për të akuzuarin A.S., në raport me veprën penale që e ngarkon aktakuza e prokurorisë. Gjendja faktike është ndryshuar pas administrimit të provave nga të cilat nuk ka mundur të vërtetohet në asnjë mënyrë të vetme se intenca e të akuzuarit

kishte qenë shitja apo shpërndarja e substancës narkotike tek personat e tretë, ngase të njëjtën e ka poseduar për konsum personal, madje edhe më parë ka rënë ndesh me ligjin në raport me vepra penale të narkotikëve, si person përdorues – konsumues dhe në rastin konkret nuk ka mundur që të provohet përshkrimi si në aktakuzën e prokurorisë, përkatësisht rrethana se i akuzuari kishte qëllim të shpërndarjes dhe shitjes së substancës narkotike. Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, gjykata sipas detyrës e ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga: “*Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së*”, në veprën penale “*Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 i KPRK-së*”.

#### *Elementet e veprës penale*

Neni 269, paragrafi 1 të KPRK-së, ka përcaktuar se formën themelore të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge e kryen kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar*

Rrjedhimisht gjykata pas shqyrtimit dhe administrimit të provave në këtë çështje penale, vlerësimi me ndërjegje të secilës provë një nga një dhe në lidhje reciproke me njëra - tjetrën, ka vërtetuar se me veprimet e të akuzuarit A.S., konsumohen elementet e veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge. Në rastin konkret gjykata ka vërtetuar faktin se me datë 06.10.2022 në F. K., derisa i akuzuari i lartpërmendur kishte qenë në veturën e tipit “O. I.” me targa ..., së bashku me një person tjetër G.R. (e për të cilin prokuroria fillimisht kishte nisur hetimet, siç provohet nga Aktvendimi për fillim të hetimeve i evidentuar nën shenjën PP/I.nr.802/2022, të datës 07.10.2022, nën dyshimin se në bashkëkryerje me të akuzuarin A.S., kanë kryer veprën penale *Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së*, e që me datë 02.12.2022, ka marrë aktvendim për pushimin e hetimeve kundër të pandehurit G.R. ngase nuk ka ekzistuar dyshimi i arsyeshëm se i njëjti ka kryer veprën penale të lartcekur), e kishte marrë me vete personin G.R. e që qëllimi i tyre kishte qenë për të pirë kafe në P. Gjatë rrugës i akuzuari kishte blerë substancë narkotike tek lokalet e “L.” nga një person me nofkën B., të cilin e kishte njohur edhe më parë, ku fillimisht i kishte kërkuar dhjetë qese substancë

narkotike, mirëpo meqenëse personi në fjalë substancën ia kishte dhënë me një çmim më të ulët i akuzuari kishte blerë edhe sasi tjetër, në shumën prej 250,00 (dyqind e pesëdhjetë) euro. Personi që kishte qenë me të në veturë nuk kishte pasur njohuri lidhur me substancën narkotike, ndërsa sa kishin qenë në veturë kishin shkaktuar kundërvajtje në komunikacion dhe Zyrtarët policor të Stacionit Policor në F. K., gjatë patrollimit në Rrugën e P., kishin ndaluar veturën në fjalë dhe me rastin e legjitimit të te akuzuarit A.S., kanë ndjerë aromën e substancës narkotike Marihuanë, që kishte qenë duke e tymosur në ato momente, ku të njëjtin e kanë urdhëruar që të del nga vetura për t'a kontrolluar dhe në ato momente me shpejtësi të madhe kanë ikur me veturë. Nga dritarja e veturës në rrugën "A. Zh." ka hedhur një qese me substancë narkotike të dyshuar si marihuanë. Policia pas kërkimit të asistencës dhe nga njësitë tjera, kishte arritur t'a ndalë veturën të cilën ishte duke e drejtuar i akuzuari t'a arrestojë të njëjtin së bashku me personin tjetër të lartpërmendur si dhe të bëjë identifikimin e substancës narkotike të te akuzuarit. I akuzuari si person konsumues edhe më herët kishte rënë ndesh me ligjin, gjegjësisht i njëjti ishte ngarkuar lidhur me veprat penale të narkotikëve (si posedues), andaj në rastin konkret nuk ka vend për mëdyshje se i njëjti substancën narkotike të cilën e kishte blerë ditën kritike tek lokalet e "L." e kishte poseduar për shpërndarje – shitje tek personat tjerë siç ka pretenduar organi i akuzës. Në anën tjetër nën supozimin se substancat narkotike të cilat i janë gjetur të njëjtit i kishte poseduar për shpërndarje - shitje, organi i akuzës, shkresave të lëndës, nuk i ka ofruar asnjë provë të vetme, e cila do t'a bindte gjykatën se intenca e të akuzuarit, kishte qenë shitja – shpërndarja tek personat e tjerë, me qëllim të përfitimit. Andaj, meqenëse prokuroria ka dështuar që të ofrojë provë në raport me veprën penale *Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 267 paragrafi 1 të KPRK-së*", kjo gjykatë bazuar në gjithë rezultatit e procedimit, përkatësisht në gjendjen faktike të vërtetuar, si më sipër sipas detyrës zyrtare e ka bërë ri cilësimin e veprës penale në *Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 i KPRK-së*".

#### *Vlerësimi lidhur me pretendimet e mbrojtjes të te akuzuarit*

Gjykata me kujdes të shtuar ka analizuar edhe pretendimet e mbrojtësit të te akuzuarit të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor, i cili ndër të tjera e ka mohuar se i mbrojturi i tij A.S., substancën narkotike e kishte poseduar për shitje apo shpërndarje tek personat tjerë, ngase në shqyrtimin gjyqësor organi i akuzës me asnjë provë të vetme nuk ka mundur të vërtetoj dyshimin e bazuar mirë, në raport me veprën penale që i vihet në barrë të mbrojturit të tij duke kërkuar nga gjykata

të shqyrtoj dispozitat të cilat i referohen kualifikimit ligjor të veprës penale, gjegjësisht nenit 269 të KPRK-së, e cila dispozitë i atribuohet posedimit të paautorizuar të narkotikeve, veprë penale kjo për të cilën i mbrojturi i tij edhe në seancën e shqyrtimit fillestar kishte shprehur gatishmëri që t'a pranojë fajësinë. Në rastin konkret për gjykatën tani më nuk është kontestuese se i akuzuari A.S., ka qenë përdorues i substancave narkotike, të njëjtën sasi të saj e kishte blerë vetëm për konsum personal, e jo edhe për shpërndarje apo shitje tek personat e tjerë dhe se kjo gjykatë si më sipër bazuar në dispozitën ligjore nga neni 359 të KPPRK-së, sipas detyrës zyrtare e ka bërë edhe ri kualifikimin e veprës penale, të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

#### *Vlerësimi i gjykatës lidhur me pretendimet e të akuzuarit*

Gjykata në këtë çështje penale po ashtu me kujdes të shtuar ka vlerësuar dhe analizuar me deklaratat e të akuzuarit të dhëna në prokurori me datë 01.12.2022 si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, të njëjtat nuk kishin diskrepancë mes tyre, përkundër faktit se ka kaluar një kohë e gjatë afro dy vite. I akuzuari edhe më parë kishte deklaruar se ishte përdorues i këtyre substancave, duke treguar saktë kohën, vendin dhe personin, nga i cili ishte furnizuar me të njëjtat dhe arsyeja pse i ishte gjetur ajo substancë me qese të ndara kishte qenë se i ishte ofruar me një çmim më të volitshëm. Të njëjtën e kishte blerë për përdorim, meqenëse e kishte konsumuar në baza ditore, madje edhe me rastin kur është ndaluar nga ana e zyrtarëve policor, kishte qenë duke tymosur marihuanë në veturë, të cilët e kishin vërejtur (nuhatur) aromën e saj.

#### *Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të sanksionit penal*

Me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Në këtë drejtim gjykata rrethana lehtësuese nuk gjeti, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit të kryer me dashje direkte dhe paramendim, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur shoqërore, veprat penale të kësaj natyre të narkotikut janë në trend të rritjes, ku tregon rrezikshmërinë e lartë kriminale, cenon vlerat e mbrojtura shoqërore, jetën dhe shëndetin e të rinjve si vlerë e rëndësishme e shoqërisë. Po ashtu si rrethanë rënduese mori faktin se i akuzuari është person recidivist, i njëjti edhe më parë ka rënë ndesh me ligjin, duke kryer vepra të ndryshme penale dhe i njëjti është dënuar edhe me aktgjykime të formës së prerë sipas lëndëve: 1.PKR-582/2016, i formës së prerë me datë

10.01.2017, vepra penale: 329 Grabitja, dënimi: dënim me burgim Dy (2) vite, e gjashtë (6) muaj dhe dënim me gjobë 600,00 (gjashtëqind) euro; 2. P-33/2019 – Pejë, i formës së prerë me datë 09.09.2019, vepra penale: 273 Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge dhe 281 Dënimi për raste të rënda të veprave penale nga ky Kapitull, dënimi: dënim me burgim dy (2) vite e tetë (8) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 800,00 (tetëqind) euro; 3. P-519/2018 – Vushtrri, i formës së prerë me datë 24.03.2021, vepra penale: 275 Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge, dënimi: dënim me gjobë 200,00 euro; 4. P-266/2023 – Glllogoc, i formës së prerë me datë 01.12.2023, vepra penale: 313 Vjedhja, dënimi: dënim me gjobë në shumë prej 500,00 (pesëqind) euro; 5. P-2153/2023 - Fushë Kosovë, i formës së prerë me datë 20.03.2024, vepra penale: 366 Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, dënimi: dënim me gjobë në shumë prej 500,00 (pesëqind) euro, vendime këto të cilat janë siguruar nga Sistemi i evidencës penale të kësaj gjykate.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të aktgjyqimit është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen e kryesit, me rrethanat e kryerjes, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, si dhe me përgjegjësinë e kryesit. Sipas bindjes së gjykatës, ky dënim përveç që do të mundësoj risocializimin dhe riedukimin e kryesit, i njëjti do të ndikojë edhe tek të tjerët që të mos kryejnë vepra penale, gjegjësisht do të ndihmojë në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme lidhur me detyrimin për respektimin e ligjit, i cili është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së.

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim të te akuzuarit është marrë konform neni 79 paragrafi 1 të KPRK-së.

Vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me gjobë në dënim me me burgim, është marrë konform nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e substancës narkotike është marrë konform nenit 276 paragrafi 1 dhe 2, nën paragrafi 2.2 të KPPRK-së, lidhur me nenin 269 paragrafi 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale - paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 452 të KPPRK-së, si dhe nenit 36 paragrafi 3, pika 3.2 të Ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimet.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË**

Departamenti i Krimeve të Rënda

PKR.nr.140/23, datë 02.09.2024

Zyrtare ligjore,  
Dalina Kërqeli - Abdullahu

Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari,  
Gazmend Bahtiri

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej tridhjetë (30) ditëve, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për gjykatën dhe palët.